

REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI „NËNË TEREZA” NË SHKUP



K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN “NËNË TEREZA” NË SHKUP NË VITIN AKADEMIK 2018/2019

Në bazë të nenit 103 paragrafi 2, nenet 149 dhe 151 të Ligjit për Arsimin e Lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.82/18), e lidhur me Vendimin e Këshillit të Rektoratit të Universitetit nr. 0202-334/1 prej 13.03.2018 dhe Vendimin i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për numrin e studentëve për regjistrim në vitin e parë - cikli i parë i studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë në përbërje të Universitetit “Shën Cirili dhe Metodi” në Shkup, Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir, Universiteti i Tetovës, Universiteti “Goce Dellçev” në Shtip, Universiteti i shkencave informatike dhe teknologjive “Shën Apostoll Pavle” Ohër dhe *Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup* në vitin akademik 2018/2019, nr. 44-4492/1 të datës 02.05.2018 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr 84/18 prej 09.05.2018), Vendimin për ndryshimin e vendimit për numrin e studentëve për regjistrim në vitin e parë - cikli i parë i studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë në përbërje të Universitetit “Shën Cirili dhe Metodi” në Shkup, Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir, Universiteti i Tetovës, Universiteti “Goce Dellçev” në Shtip, Universiteti i shkencave informatike dhe teknologjive “Shën Apostoll Pavle” Ohër dhe *Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup* në vitin akademik 2018/2019, nr. 44-7307/1 të datës 24.07.2018 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.142/18), **Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup**, shpall konkurs për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve akademike.

I. Numri i studentëve

Në njësitë (fakultetet) e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në vitin e parë të ciklit të parë të studimeve në vitin akademik 2018/19, do të mund të regjistrohet numri i studentëve si në vijim:

FAKULTETET DHE PROGRAMET STUDIMORE	Studentë të rregullt me kuota shtetërore	Shuma e pagesës (Vjetore EURO)	Të rregullt me kofinansim	Shuma me kofinansim (Vjetore EURO)	Të çrregullt	Shuma me kofinansim (Vjetore EURO)	Numri i pergjithshëm I
FAKULTETI I SHKENCAVE INFORMATIKE	190	200	80	400	40	400	310
Informatikë	100	200	30	400	10	400	140
Informatikë- mësimdhënie	40	200	20	400	10	400	70
Programim i aplikuar	50	200	30	400	20	400	100

FAKULTETI I SHKENACVE TEKNOLOGJIKE		100	200	50	400	20	400	170
Inxhinieri e materialeve dhe nanoteknologji		20	200	10	400			30
Teknologjia ushqimore		40	200	10	400			50
Agroinxhineria		20	200	10	400			30
Dizajni dhe modelimi i tekstilit		20	200	20	400	20	400	60
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE		260	200	110	400	70	400	440
Sistemet elektroenergjetike		20	200	5	400			25
Inxhinieri makinerike dhe manaxhment		20	200	5	400			25
Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit		30	200	20	400			50
Mekatronikë		30	200	20	400			50
Menaxhment industrial		20	200	10	400	10	400	40
Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarrësi		70	200	20	400	20	400	110
Inxhinieria për mbrojtje të ambientit të punës dhe jetesës		30	200	10	400	10	400	50
Profili	Inxhinieria për mbrojtje të mjedisit jetësor							
	Inxhinieria për mbrojtje të shëndetit gjatë punës							
PROGRAM UNIVERSITAR INTERDISCIPLINOR Dogana,shpeditcion dhe sigurime		40	200	20	400	30	400	90
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS		90	200	30	400			120
Arkitekturë dhe dizajn		50	200	20	400			70
Ndërtimtari- konstruktive		20	200	5	400			25
Gjeodezi dhe gjeoinformatikë		20	200	5	400			25
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE		230	200	85	400	100	400	415
Punë dhe politike sociale		80	200	30	400	20	400	130
- Punë sociale								
- Gerontologji								
Media dhe komunikim nderkulturor		30	200	10	400	10	400	50
Pro	Komunikim							
	Gazetari							
Sport dhe shkencat e sportit*		30	200	20	400	30	400	80
Studime Ballkanike dhe Euroaziatike		20	200	5	400	10	400	35
Administratë publike dhe menaxhim i resurseve humane		40	200	10	400	20	400	70
Studime evropiane (Gjuhë Angleze)		30	200	10	400	10	400	50
UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" NË SHKUP		870		355		230		1455

*Për programin studimor Sport dhe shkencat sportive kërkohet çertifikat e mjekut për gjendjen shëndetsore

II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

1. Të drejtë regjistrimi për studimet e ciklit të parë kanë kandidatët që kanë dhënë maturën shtetërore ose maturë ndërkombetare.

2. Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët kanë dhënë maturë shkollore ose provim përfundimtar. Nëse në afatin e parë nuk paraqitet numër i mjaftueshëm i kandidatëve që i plotësojnë kushtet sipas pikës paraprake, të drejtë për regjistrim kanë edhe kandidatët të cilët kanë të kaluar maturën shkollore ose provim përfundimtar në shkollimin e mesëm të caktuar në shkollat e mesme të verifikuara me akt të Ministrisë së arsimit dhe shkencës.

3. Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm katërvjeçar para vitit akademik 2007/08.

4. Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt të financuar nga shteti dhe studentë të rregullt me bashkëfinancim të studimeve. Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe studentë me korrespondencë, nëse këtë e mundëson karakteri i programit studimor.

5. Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe kandidatët të cilët kanë të kryer arsimim të lartë apo sipëror, në fakultetet e ngjashme dhe shkollat e larta. Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar në Konkurs. Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm, përveç në programet studimore për të cilët, për shkak të specifikave nevojitet kontrollimi i talentit. Ngjashmërinë e vërtetojnë dhe e shpallin fakultetet. Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me ko-financim të studimeve, si dhe kandidatët nga kreu V i konkursit.

6. Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet varësisht nga lloji i programeve studimore në të cilat konkurrojnë ata, edhe atë:

a) programe studimore ku seleksionimi i kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimit I mesëm;

b) programe studimore ku seleksionimi do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimit i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Kjo ka të bëjë me programet studimore me specifika të veçanta.

c) programe studimore ku mësimi mbahet në gjuhën angleze, ku seleksionimi do të kryhet nga sukcesi i shkollimit të mesëm dhe rezultati nga intervistimi nga komisioni përkatës.

7. Kriter bazë për seleksionimin e kandidatëve për regjistrim të studimeve deridiplomike është sukcesi i arritur në arsim të mesëm. Vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë.

Në programet studimore ku seleksionimi kryhet vetëm përmes suksesit të arsimit të mesëm, kandidatët mund të fitojnë me së shumti 100 pikë, edhe atë: sukcesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët merr pjesë me 60%, ndërsa sukcesi i arritur në maturën shtetërore merr pjesë me 40%.

1) Në programet studimore ku seleksionimi do të kryhet vetëm në bazë të suksesit të arritur në arsimin e mesëm, llogaritja e pikëve bëhet në këtë mënyrë: mblidhen të gjitha notat, të cilat janë të evidentuara në dëftesat e notave nga të gjitha vitet, shuma e përgjithshme e fituar pjesëtohet me numrin e notave, kështu që sukcesi mesatar i fituar shumëzohet me numrin 12. Me këtë më së shumti mund të fitohen 60 pikë.

2) Për kandidatët të cilët kanë dhënë maturën shtetërore pas vitit shkollor 2013/2014 rangimi i suksesit të arritur gjatë dhënies së maturës shtetërore merr më së shumti 40 pikë dhe përlllogaritet në mënyrën si vijon:

Për të tre lëndët ekterne:

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë lëndë ekterne që është përkatëse për programin studimor në të cilin konkurojnë (Lista 1), në notën e çdo lënde ekterne shtohet rangi përpjestimor i kandidatit (i shprehur në përqindje) për lëndën përkatëse të pjesëtuar me 20.

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë lëndë ekterne që nuk është përkatëse për programin studimor në të cilin konkurojnë (Lista 1), pikët nga ajo lëndë, të fituara sipas metodologjisë më sipër, shumëzohen me faktorin 0,5. Sipas kësaj mund të fitohen më së shumti 30 pikë për të tre lëndët ekterne.

Për lëndën interne:

- Rangimi sipas notës së lëndës interne (Lista 1) të përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 1,2, me të cilën fitohen maksimum 6 pikë,
- Rangimi sipas notës së lëndës interne (Lista 1) jo të përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 0,6 me të cilën fitohen më së shumti 4 pikë.

Për detyrën e projektit:

- Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0,8. Në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika.

3) Për kandidatët të cilët kanë dhënë maturën shtetërore deri në vitin 2012/13 rangimi i suksesit të arritur gjatë maturës shtetërore arrin më së shumti 40 pikë dhe llogaritet si vijon:

Për të dy lëndët eksterne:

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë lëndë ekstere që është përkatëse për programin studimor në të cilin konkurojnë, në notën e çdo lënde ekstere shtohet rangi përpjestimor i kandidatit për lëndën përkatëse të pjesëtuar me 20.

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë lëndë ekstere që nuk është përkatëse për programin studimor në të cilin konkurojnë, pikët nga ajo lëndë shumëzohen me faktorin 0,5. Sipas kësaj mund të fitohen më së shumti 20 pikë për të dy lëndët eksterne.

Për të dy lëndët interne:

- Rangimi sipas notës së lëndës interne të përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 1,6.

- Rangimi sipas notës së lëndës interne jo të përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 1.

Shumat e fituara në këtë mënyrë mbliidhen. Sipas kësaj mund të fitohen më së shumti 16 pikë për të dy lëndët e përshtatshme, 13 pikë për një të përshtatshme dhe një të papërshtatshme dhe 10 pikë për dy lëndë jo të përshtatshme

Për detyrën e projektit:

- Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0,8. Në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika.

4) Për kandidatët të cilët shkollën e mesme e kanë mbaruar në vitet e mëparshme shkollore (para vitit shkollor 2007/2008) dhe nuk kanë mbaruar maturë shtetërore, përveç llogaritjes së pikëve nga pika 7. 1, llogariten edhe më së shumti 40 pikë nga lëndët të cilët janë të rëndësishme për programin studimor, edhe atë: shuma e notave nga dy lëndë të rëndësishme për programin studimor dhe dy lëndët nga lëmia e gjuhëve (gjuhë amtare dhe një gjuhë botërore) pjesëtohet me 16, dhe kështu, sukcesi mestar i secilës lëndë veçmas shumëzohet me 8. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti 10 pikë për një lëndë, përkatësisht 40 pikë për katër lëndët.

5) Vlerësimi i suksesit të kandidatëve të cilët kanë dhënë maturë shkollore ose provim përfundimtar të shkollimit të mesëm katërvjeçar bëhet: Notat e lëndëve të përshtatshme të cilat i kalojnë në mature shkollore shumëzohen me koeficientin 1,6, ndërsa me lëndë jo të përshtatshme me 0,8, kurse detyra projektuese me 0,8. Me këtë mund të fitohen maksimum 20 pikë.

6) Vlerësimi i suksesit në programet studimore me kontrollim të talentit: mbliidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat, nga të gjitha vitet, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, sukcesi mestar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti 60 pikë. Vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i talentit bëhet me fitimin nga 0 deri në 40 pikë. Kontrollimi ka karakter eliminues me minimum 10 pikë, ndërsa në Fakultetin Pedagogjik me 20 pikë. Kontrollimi i njohurive sipas procedurës së njëjtë do të bëhet në mjekësi të përgjithshme, stomatologji dhe farmaci për kandidatët shtetas të huaj, kandidatë me lëndë interne dhe ekstere jo të përshtatshme, kandidatë me maturë shkollore, kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin e mesëm jashtë RM-së dhe kandidatët që nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm para vitit shkollor 2007/08.

Kandidatët të cilët arrijnë më pak se 40 pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve nuk do të pranohen.

III. Seleksionimi i kandidatëve

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Rektorati formon Komision universitar të Konkursit.
2. Për llogaritjen e pikëve nga sukcesi i arritur nga arsimi i mesëm dhe nga sukcesi i maturës shtetërore ose maturës shkollore, Rektorati formon Komisione të konkursit për secilin fakultet veçmas, ndërsa programet studimore ku bëhet kontrolli i talentit, formojnë Komisione edhe për kontrollimin e talentit. Komisioni universitar i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit, jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij.

3. Rangimin e kandidatëve e kryejnë Komisionet e veçanta të fakulteteve.

4. Komisioni për Konkurs, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin sipas poenave nga suksesi i arsimit të mesëm (suksesin mesatar), pikët e lëndëve eksterne, interne dhe nga rezultatet e kontrollimit të talentit nga programet studimore në të cilat ai zbatohet (në tabelën e rezultateve do të shpallen edhe të dhënat: numri i dosjes, emri, prindi dhe mbiemri, vendbanimi, shtetësia, suksesi për çdo vit shkollor, pikët e fituara nga matura shtetërore/shkollore, pikët e fituara dhe statusi i pranimit). Pas shpalljes së rang listës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh përmes arkivit ose formës online. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura. Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike-gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njëjti i drejtohet Komisionit universitar për pranimin e studentëve. Aktvendimi i Komisionit është përfundimtar. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni universitar i Konkursit në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (Rang lista përfundimtare) , në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ato të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankimi. Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim në shërbimet studentore të fakultetit në të cilin janë pranuar, konsiderohet se kanë hequr dorë nga studimet dhe vendi i tyre do të shpallet si i lirë në Konkursin e radhës.

5. Fakultetet në të cilët edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të plotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.

IV. Regjistrimi i studentëve në kuotën shtetërore

1. Studentët në kuotën shtetërore regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studimeve, në shumë prej 200 euro, në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RM. Kompensimi për studime të studentëve nga paragrafi paraprak, kryhet në dy këste të barabarta, gjatë regjistrimit të semestrit dimëror, gjegjësisht semestrit veror.

Kompensimi nga paragrafit 1 i kësaj pike, studentët të cilët e mbajnë statusin e studentit të rregullt me kuotë shtetërore në pajtim me Statutin e Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup, e paguajnë gjatë tërë procesit studimor.

2. Nëse në afatin e parë regjistrues, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë candidate), fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë fakulteti kandidatët e tillë i rangon sipas kritereve plotësuese: përshtatshmëria e projekt detyrës së punuar gjatë dhënies së provimit të maturës shtetërore, çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, anëtare të reprezentacioneve sportive të Republikës së Maqedonisë, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj.

V. Regjistrimi i studentëve me koofinancim të studimeve

1. Në fakultetet, si studentët të rregullt regjistrohen edhe kandidatë që i plotësojnë kushtet për regjistrim, ndërsa për shkak të kufizimit të kuotave nuk mund të regjistrohen në kategorinë e studenteve të financuar nga shteti.

2. Studentët që regjistrohen në këtë kategori, paguajnë kompensim të studimeve, në lartësi prej 400 euro, në kundërvlerë të denarit, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RM-së, në ditën e pagesës, në së paku 2 këste të barabarta.

3. Fakulteti shpall listën e rangimit të kandidatëve që i plotësojnë kushtet për regjistrim në këtë kategori. Kandidatët që pajtohen të regjistrohen në këtë kategori studentësh, dorëzojnë deklaratë në afat prej 24 orësh pas shpalljes së listës përfundimtare të rangimit, së pajtohen gjatë gjithë kohës së studimeve të marrin pjesë në koofinancim të studimeve. Studenti i cili regjistron studimet sipas rezultateve të pranimit në koofinancim, konsiderohet se pranon të koofinancojë studimet.

Listën e candidateve të pranuar në këtë kategori e vërteton Komisioni i Konkursit në bazë të listës së rangimit dhe deklaratave të dorëzuara për pajtueshmëri për regjistrim në këtë kategori. Studentët me bashkëfinancim gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.

VI. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë

1. Në programet studimore të veçanta në fakultete, si student me korrespondencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studente të rregullt. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjek mësimin e rregullt; sëmundje e rëndë afatgjate, e cila pamundëson vijimin e rregullt të mësimin me tepër se një semester; prind i fëmijes deri sa zgjate pushimi i lehonisë.

2. Studentët me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit.

Studentët që regjistrohen në këtë kategori, paguajnë studimet në lartësi prej 400 euro, në kundërvlerë të denarit, sipas kursit mesatar të Bankes Popullore të RM-së, në ditën e pagesës, në së paku 2 këste të barabarta.

3. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespondencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar, ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.

VII. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit, kandidatët me mature ndërkombëtare, dhe kandidatët nga shkollat e mesme private në RM.

a) Shtetasit e huaj.

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs dhe numri i tyre mund të jetë 20% nga numri i përgjithshëm i studentëve të përcaktuar me konkurs në nivel të fakultetit, përveç programeve studimore ku mësimin realizohet në gjuhën angleze.

2. Seleksionimi i shtetasve të huaj që paraqiten për studim në programet studimore Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës, Fakulteti i shkencave të informatikës, Fakulteti i shkencave teknologjike, Fakulteti i shkencave teknike dhe fakultetit I shkencave sociale kryhet me anë të kontrollit të diturive dhe aftësive.

3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë në cilin fakultet, respektivisht program studimor dëshirojnë të studiojnë, se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë diplomë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase ose shqipe (të dhënë nga komisioni i Universitetit), dhe certifikatë për gjendjen shëndetësore (HIV test dhe hepatit C). Shtetasit e huaj, për diplomën për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe dëftesat për të gjitha klasat, para fillimit të vitit akademik duhet të dorëzojnë vendimin për nostrifikim nga institucioni kompetent i RM-së, respektivisht dokumentet për fillimin e procedurës për nostrifikim. PAGESA E STUDIMEVE PËR SHTETASIT E HUAJ PËR VITIN 2018/19 ËSHTË 300/500 EURO PËR NJË SEMESTËR RESPEKTIVISHT 600/1000 PËR NJË VIT AKADEMIK. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë. Kandidatët shtetas të Republikës së Turqisë do të mund të regjistrohen vetëm sipas kriterëve të miratuara nga ana e Këshillit për arsim të lartë të Republikës së Turqisë-YOK, të cilët duhet të dorëzojnë dëshmi për dhënien e provimit pranues të organizuar nga YGS. Shtetasit e huaj, të cilët kanë kryer arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë, gjatë përlllogaritjes së pikëve do të trajtohen sipas kriterëve për shtetasit e RM-së, por statusi i kandidatit do trajtohet si kandidatët e këtij kreu. Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim.

b) Mërgimtarët dhe shtetasit e RM-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi, arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit, kandidatët shtetas të RM-së me maturë ndërkombëtare dhe kandidatët me shkollim të mesëm në shkollat private në RM

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë dhe kandidatët shtetas të RM, që arsimin e mesëm të plotë e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen jashtë kuotave, me koofinancim të studimeve.

2. Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1, në programet studimore Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës, Fakulteti i shkencave të informatikës, Fakulteti i shkencave teknologjike, Fakulteti i shkencave teknike dhe fakultetit i shkencave sociale kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive.

3. Kompensimi për studime i kësaj kategorie të studentëve, në varësi të programeve studimore, është përcaktuar në kreun I të Konkursit (si për kandidatët nga kreu VI), respektivisht 400 euro një vit akademik. Kandidatët shtetas të RM-së të cilët kanë kryer pjesërisht shkollimin e mesëm jashtë vendit, mund të regjistrohen edhe sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Konkurs për kandidatët me arsim të mesëm të kryer në RM, në kuadër të kuotës shtetërore. Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë diplomë të nostrifikuar si dhe dëftesa të nostrifikuara për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.

4. Kandidatët shtetas të RM-së, maturë të mbaruar ndërkombëtare, regjistrohen me kushte dhe kritere të njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit, përkatësisht me maturë të kryer ndërkombëtare. Këta kandidatë rangohen në rang - listë të veçantë, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë aq pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës shtetërore në programin studimor përkatës. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti 10%, kurse shpenzimet për studimet e tyre i bart Ministria për Arsim dhe Shkencë. Kandidatët të cilët kanë fituar pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kategorinë me koofinancim të studimeve, regjistrohen me kompensim për studime në lartësi të përcaktuar sipas kreu I të Konkursit. Për kandidatët të cilët regjistrohen në këtë kategori, me koofinancim të studimeve, vlejshëm dispozitat nga kreu VI i Konkursit. Kandidatët nga kreu i VII pika (b), paraqiten në Rektoratin e Universitetit, në afatet e përcaktuara me Konkurs.

5. Kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin e mesëm në shkolla private të akredituara në RM, me maturë shtetërore, do të trajtohen njëjtë si kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin në Republikën e Maqedonisë. Ndërsa kandidatët me shkollim të mesëm privat pa maturë shtetërore në RM, do të rangohen në listë të veçantë me koofinancim të studimeve, jashtë kuotave tjera të përcaktuara, por jo më shumë se 10% nga numri i përgjithshëm i vendeve të lira në programin studimor.

VIII. Kandidatët me të drejta të veçanta të përcaktuara sipas ligjeve të RM si dhe kandidatët të cilët pranohen në kuadër të kuotës së bashkësive të cilët nuk janë shumicë në R. Maqedonisë.

1. Numri i studentëve, që i takojnë kategorisë së personave me të drejta të veçanta të përcaktuara me Ligjin për të drejta të veçanta të RM, regjistrohen në kuotë të veçantë (pa bartje të shpenzimeve për studime), numri i tyre mund të arrijë më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në nivel të programit studimor.

2. Për sigurimin e përfaqësimit të drejt të kandidatëve të cilët u takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë në R. Maqedonisë, në institucionet e larta të Universitetit, në vitin akademik 2018/19, në mënyrë plotësuese do të regjistrohen kandidatët të cilët u takojnë këtyre bashkësive, numri i të cilëve të mos e kalon 10 % nga numri i përgjithshëm i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë në nivel të fakultetit. Në kuadër të kësaj përqindjeje, në mënyrë të drejtë do të përfaqësohen kandidatët e të gjitha bashkësive, deri në përqindje me të cilin bashkësia përkatëse është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në R. Maqedonisë.

3. Përqindja e studentëve – përfaqësues të këtyre bashkësive, si në kuotën shtetërore dhe në atë plotësuese, duhet të jetë deri në përqindjen e përfaqësimit të bashkësisë përkatëse në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Republikës së Maqedonisë.

4. Universiteti nuk do të kërkon pagesë nga:

- fëmijët pa prindër deri në moshën 26 vjeçare, nëse janë të papunë,
- personat me invaliditet të kategorisë së parë dhe të dytë,
- invalidë të luftës,
- persona të rritur në institucione për përkujdesje të fëmijëve deri në moshën 26 vjeçare, nëse janë të papunë.

Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar me Konkurs.

Mjetet për participim të këtyre personave sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

IX. Afatet për paraqitje dhe regjistrimi:

REALIZIMI I KONKURSIT PER REGJISTRIM TË STUDENTEVE	Afati i parë	Afati i dytë	Afati i tretë
Aplikimi (paraqitja e kandidatëve)	27 Gusht- 31	14-18 Shtator	25 Shtator
Shpallja e rezultateve preliminare	05 Shtator	19 Shtator	26 Shtator
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	07 Shtator	21 Shtator	28 Shtator
Regjistrimi i kandidatëve	10-13 Shtator	21-24 Shtator	28 Shtator-01 Tetor

X. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim:

1. Fletëaplikim (merret në hapësirat e Universitetit)
2. Dëftesa origjinale nga shkollimi i mesëm
3. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme
4. Çertifikatë nga libri amzë i të lindurve
5. Çertifikatë për nënshtetësi
6. Vërtetim për pagesat e:

a) **800 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

b) **600 denarë** mjete plotësuese për secilën lëndë të cilës kandidatët do të nënshtrohen për provim pranues të theksuar në Listën shtesë-1, të Programit studimor përkatës, ku është paraparë provimi pranues: në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive dhe intervistimit (për programet në gjuhën angleze).

Kandidatët që aplikojnë në programet ku mundësohen studime me korrespondencë, krahas dokumentacionit të caktuar më lartë, duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse për arsyetimin e këtij statusi sipas kriteve të përcaktuara në këtë konkurs.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes së listës përfundimtare), gjatë regjistrimit duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studentit regjistrohet)
2. Tre fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5cm.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - ❖ **100 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të parlamentit studentor..
 - ❖ **800 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indexit.
 - ❖ **750 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
 - ❖ **Pagesën e mjeteve për semestrin e parë.**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

- ❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup,
- ❖ Në „banka e marrësit” (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
- ❖ Në „llogaria” (**сметка**) – 100000000063095,
- ❖ Në „shuma” (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhet,
- ❖ Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues” (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – 1600162677 788 15; Shifra (Приходна шифра) 723012, programi (програма) 45.

Konkursi është shpallur edhe në web-faqen e Universitetit: www.unt.edu.mk

Lista 1

Lista e lëndëve eksterne dhe interne nga matura shtetërore të përshtatshme për paraqitjen dhe regjistrimin në programet studimore të Universitetit „Nënë Tereza” në Shkup për kandidatët që kanë dhënë maturën shtetërore nga viti 2013/2014 deri më sot.

1. Për të gjithë kandidatët provim i detyrueshëm ekstern është lënda: gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi turke.
2. Provim i parë zgjedhorë ekstern për kandidatët me shkollim të gjimnazeve dhe me shkollim të mesëm profesional është lënda: matemaikë ose gjuhë botërore, ndërsa për kandidatët me shkollim të mesëm artistik është: gjuhë botërore ose estetikë/filozofi.
3. Në tabelën më poshtë janë dhënë lënda e dytë zgjedhore eksterne dhe lënda interne, të cilat kandidatët i përzgjedhin gjatë dhënies së maturës shtetërore, ndërsa janë të rëndësishme për programin përkatës studimor.

FAKULTETET DHE PROGRAMET STUDIMORE		Lënda zgjedhore e dytë eksterne	Lënda zgjedhore interne
FAKULTETI I SHKENCAVE INFORMATIKE			
Informatikë		Pa kufizim	Pa kufizim
Informatikë- mësimdhënie		Pa kufizim	Pa kufizim
Programim i aplikuar		Pa kufizim	Pa kufizim
FAKULTETI I SHKENACVE TEKNOLOGJIKE			
Inxhinieri e materialeve dhe nanoteknologjive		Njëra nga lëndët patjetër të jetë matematika	Pa kufizim
Teknologjia ushqimore		Pa kufizim	
Agroinxhineria		Pa kufizim	Pa kufizim
Tekstil dizajn dhe modelimi		Pa kufizim	Pa kufizim
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE			
Sistemet elektroenergjetike		Njëra nga lëndët patjetër të jetë matematika	Pa kufizim
Inxhinieri makinerike dhe manaxhment		Njëra nga lëndët patjetër të jetë matematika	Pa kufizim
Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit		Pa kufizim	Pa kufizim
Mekatronikë		Pa kufizim	Pa kufizim
Menaxhment industrial		Pa kufizim	Pa kufizim
Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarrësi		Pa kufizim	Pa kufizim
Inxhinieria për mbrojtje të ambientit të punës dhe jetesës		Pa kufizim	Pa kufizim
Profili	Inxhinieria për mbrojtje të mjedisit jetësor		
	Inxhinieria për mbrojtje të shëndetit gjatë punës		
PROGRAM UNIVERSITAR INTERDISCIPLINOR Dogana, shpeditcion dhe sigurime		Pa kufizim	Pa kufizim
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS			
Arkitekturë dhe dizajn		Pa kufizim	Pa kufizim
Ndërtimtari- konstruktive		Pa kufizim	Pa kufizim
Gjeodezi dhe gjeoinformatikë		Pa kufizim	Pa kufizim
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE			
Punë dhe politike sociale		Pa kufizim	Pa kufizim
Profili	- Punë sociale		
	- Gerantologji		
Media dhe komunikim nderkulturor		Pa kufizim	Pa kufizim
Profili	Komunikim		
	Gazetari		
Sport dhe shkencat e sportit		Pa kufizim	Pa kufizim
Studime Ballkanike dhe Euroaziatike		Pa kufizim	Pa kufizim
Administratë publike dhe menaxhim i resurseve humane		Pa kufizim	Pa kufizim

Studime evropiane (Gjuhë Angleze)	Njëra nga lëndët patjetër të jetë gjuhë botërore	Pa kufizim
-----------------------------------	--	------------